

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Gani Avdiu e Gëzim Llulluni anëtarë, në çështjen kontestimore të paditëses Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale - Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson F.A., kundër të paditurit I.A. nga fshati ... – Gjilan, objekti i kontestit pasurimi i pabazë, vlera e kontestit 880 €, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1055/07 të dt. 18.01.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 05.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së të paditurit, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. C.nr.1055/07 të dt. 18.01.2013, vetëm sa i përket kamatës në shumën e gjykuar dhe gjykohet: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se 1 (një) vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë prej dt.18.01.2013 e deri te pagesa e plotë, ndërsa sa i përket pjesës tjetër ankesa e të paditurit REFUZOHET si e pathemeltë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1055/07 i dt. 18.01.2013, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Historiku procedural:

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, është miratuar si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale - Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës në Prishtinë, dhe është detyruar i padituri I.A. nga fshati ... – Gjilan, që paditëses në emër të pasurimit të pa bazë, t'ia paguaj shumën prej 880 € në llogari të paditëses, me kamatë 2.5 %, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dt. 18.01.2013 e deri në pagesën definitive, si dhe shumën prej 15 € në emër të shpenzimeve procedurale, të gjitha kërkesat në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi kontestues të prishet dhe kërkesëpadia e paditësit të hedhet poshtë si e pa bazuar ose lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Pala paditëse nuk ka ushtruar përgjigjen në ankesë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë në procedurën e zhvilluar në këtë çështje kontestimore ka administruar provat dhe i ka vlerësuar ato në kuptim të nenit 8 të LPK dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike se: me vendimin e lëshuar nga MPMS – Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës të datës 26.11.2004, të paditurit i është njohur e drejta për pension për personat me aftësi të kufizuara nga data 01.01.2004, në shumën prej 40 € për muaj.

E paditura me vendimin nr. 326/5015259 të datës 29.12.2005 të paditurit ia ka ndërpre pagesën e mëtejme të pensionit, për shkak të mos plotësimit të kushteve ligjore nga neni 7 pika 2,3,4 dhe 5 të Ligjit për Pensionet për Personat me Aftësi të Kufizuara, e për faktin se punësimi në firmën NTSH “NN” nënkupton dëshminë e supozuar të aftësisë për punë. Gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj në pikën dy, ka detyruar të paditurin që ti kthej të gjitha shumat e paguara jomeritore të pensionit nga data 01.01.2004 kur i është njohur e drejta në pension e deri me datën 01.11.2005 kur i është ndërpre ky pension. Mbi këtë bazë pala paditëse ka kërkuar që i padituri mjetet e shfrytëzuara pa bazë ligjore t’ia kthej në xhirologarinë e saj. I padituri nuk e ka kontestuar se ka qenë pronarë i firmës NTSH “NN” por që këtë veprimtari e ka ushtruar para lufte e deri me datën 30.08.2004 kur biznesin e ka kaluar në emër të bashkëshortes. Nuk e ka kontestuar se në emër të pensionit ka marrë nga e paditura, shumën e përgjithshme prej 880 €.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se i padituri në këtë rast është pasuruar pa bazë e në shumën prej 880 €, ngase baza mbi të cilën e ka fituar pensionin ka pushuar, për faktin se më vonë është mësuar se i padituri në kohën kur ka aplikuar për pension ka pasur të regjistruar në emrin e tij firmën NTSH “NN” (të cilin fakt i padituri nuk e ka paraqitur te organi që ka aplikuar për pension edhe pse ka qenë i obliguar, neni 7.2 i Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara) ndërsa në nenin 3.4 të po këtij ligji është parapa që: “Punësimi aktual, duke përfshirë edhe vetëpunësimin, nënkupton dëshminë e supozuar të aftësisë për punë” dhe se për zgjedhshmëria për pensionin e aftësisë së kufizuar do të pushojë që në ditën e parë të punësimit ose të vetëpunësimit.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se i padituri ka qenë pronar i firmës NTSH “NN”, që nënkupton supozimin ligjor të aftësisë për punë dhe rënie automatike të bazës ligjore për të qenë shfrytëzuese e këtij pensioni (një rasti i tillë i pasurimit pa bazë është paraparë nenin 240 al.4 të LMD-së).

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK: “ Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur “.

Neni 195.1 i LPK “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:e) ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë “.

Vlerësimi i Gjykatës:

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të të paditurit lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pa themelta dhe vlerëson se gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykimin i cili sipas vlerësimit të Kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe ky kolegji, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se me rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të kolegjit gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet.

Kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruara nga ana e të paditurit me ankesë se gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim në favor të palës paditëse, dhe se shuma në vlerë prej 880 €, cilën pala e paditur është i obliguar ta përmbush, është jo reale, pasi që i padituri faktin që ka qenë pronarë i firmës NTSH “NN” nuk e ka paraqitur te organi që ka aplikuar për pension edhe pse ka qenë i obliguar, siç parashihet në nenin 7.2 të Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Ndërkaq, sa i përket kamatës, gjykata e shkallës së dytë Aktgjykimin e atakuar e ka ndryshuar në pjesën e dispozitivit e cila ka të bëjë me kamatën duke gjykuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që në rastin konkret kamata caktohet me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se 1 (një) vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit në shkallë të parë prej dt.18.01.2013 e deri te pagesa e plotë, në kuptim të dispozitave të nenit 277 të LMD.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe e) të LPK, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3866/13 me dt.05.09.2016

Kryetari i Kolegjit - Gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj